

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik



Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë) ☐

OPTIMA COMMUNICATION

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K71903025A

NUIS/NIPT

Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë, Shqipëri
Adresa

Tiranë

Albania

1010

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

+355672044803

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

enkelejda.buxheli@optima.al

E-mail

Administrator Elton Rama

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2026/08/26

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355672044803

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-96527-08-18-2026

Tipi i procedurës për ankesën
Procedure e Prokurimit Publik

Tipi i ankesës
Dokumenta Tenderi

Lloji i procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë

Procedurë e hapur	☐	Procedurë e hapur e thjeshtuar	☐
Procedurë e kufizuar	☐	Procedurë konkurruese me negociim	☐
Partenritet për inovacion	☐	Dialog konkurrues	☐
Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit	☐	Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	☐
Shërbim Konsulence	☐		
Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP	☐		

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Bashkia Belsh

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

4166666.00

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

“Shërbim për implementimin e programit(software) për taksat vendore”

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme) ☐

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës) ☐

Tipi i kontratës

Shërbime

Data e zhvillimit të procedurës

2026/08/31

Numri i njoftimit

CN/51591/08182026

Kodi CPV

72262000-9

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.) ☐

Ligji i Prokurimit Publik nr. 162 dt. 23.12.2020, i ndryshuar, neni 110, si edhe Rregullat e Prokurimit Publik, neni 94 dhe neni 97,

2. Objekti i ankesës ☐

- Modifikim i dokumentave të tenderit

☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate ☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavallefshmërinë)

- Tjetër ☐

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet ☐

Përshkruani rrethanat e faktit. ☐

Kompania Optima Communication sh.p.k. me NUIS K71903025A, shpreh interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim për implementimin e programit (software) për taksat vendore”, publikuar në faqen e APP-se nga autoriteti kontraktor Bashkia Belsh me datë 19.08.2026, dhe parashikuar për të zhvilluar në datë 31.08.2026.

Në gjykimin tone, ka specifikime dhe kritere për kualifikim të vendosura nga AK në këtë procedurë që janë në shkelje të LPP, prandaj bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik nr. 162 dt. 23.12.2020, i ndryshuar, neni 110, si edhe Rregullat e Prokurimit Publik, neni 94 dhe neni 97, po paraqesim këtë ankesë.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Kompania Optima Communication sh.p.k. me NUIS K71903025A, shpreh interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim për implementimin e programit (software) për taksat vendore”, publikuar në faqen e APP-se nga autoriteti kontraktor Bashkia Belsh me datë 19.08.2026, dhe parashikuar për të zhvilluar në datë 31.08.2026.

Në gjykimin tone, ka specifikime dhe kritere për kualifikim të vendosura nga AK në këtë procedurë që janë në shkelje të LPP, prandaj bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik nr. 162 dt. 23.12.2020, i ndryshuar, neni 110, si edhe Rregullat e Prokurimit Publik, neni 94 dhe neni 97, po paraqesim këtë ankesë.

PIKA 1

Në DST është percaktuar afati i levritimit:

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Afatet e ekzekutimit: 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit
Afati i ekzekutimit			
Shërbim për implementimin e programit (software) për taksat vendore			
4 166 666 pa TVSH	Bashkia Belsh	15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.	

ARGUMENT 1

Afati 15 ditor për analizimin e situatës, ndertimin e programit, implementimin, realizimin e formatit edhe për tablet dhe celulare, është jo thjesht i pamjaftueshëm, por as nuk mund të mendohet që në 2 javë të hartohet edhe thjeshtë plani i punës.

Është e domosdoshme të behen takime paraprake ku OE të njihet me situatën në institucion, të marrë nga AK të gjitha informacionet e nevojshme për të analizuar dhe endertuar një plan pune.

Me pas mund të fillohet me ndertimin e programit, i cili do të paraqitet në një mjedis testimi AK, ky i fundit do të testojë, do të bëjë komentet e veta, nëse është e nevojshme do të behen ndryshime për ta përmirësuar, me tej programi implementohet në mjedisin që do të caktojë AK.

Për një procedurë të tillë, me shumë hallka, nevojitet një afat së paku 6 muaj për realizimin e saj, ky nuk është një mall i gatshëm, është një program që do të ndertohet nga e para për Bashkinë e Belsh, sipas kërkesave të AK.

Lutemi që afati i zbatimit të jetë në përputhje me natyrën e shërbimit që kërkohet, lutemi të behet afati i zbatimit të kontratës 6 muaj.

PIKA 2

Në DST është përcaktuar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit që prokurohet

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

ARGUMENT 2

Në të dyja këto kritere, mendojmë se është bërë një lapsus në mënyrën e të shprehurit të përqindjes së kërkuar. Mendojmë që OE sigurisht që mund të kenë vlerë të xhiros me të madhe se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit dhe vlerë të përvojave të ngjashme me të madhe 20 % të vlerës së fondit të limit.

Ju lutem saktësoni që OE mund të paraqesin edhe vlera me të mëdha të xhiros dhe të përvojave të ngjashme, dhe kufijte 40% dhe 20% janë kufijte minimale, jo maksimale.

PIKA 3

Në DST është përcaktuar:

a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, Kontrata dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ARGUMENT 3

Ky kriter nuk është formuluar në përputhje me përcaktimet ligjore, duke kërkuar të paraqiten edhe kontrata të ngjashme, nderkohe që formulimi ligjor përcakton vërtetim dhe/ose fatura tatimore.

Ju lutem korrigjoni kërkesën në përputhje me RrPP, neni 41, pika 3:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me

sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

PIKA 4

Ne DST është përcaktuar:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një numër mesatar punonjësish jo më të vogël se 5 (pese)punonjes, të deklaruar për periudhën e fundit të deklaruar përpara datës së hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

ARGUMENT 4

Ne kete kriter është kerkuar që OE të paraqesë Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

Gjithashtu kerkohet të paraqiten formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Keto formulare plotësohen përpara se të dalë listepagesa e konfirmuar nga organet tatimore. Pra plotësohen dhe paguhen formularët, me pas konfirmohet listepagesa nga organet tatimore, listepagesa nuk konfirmohet nëse nuk janë paguar formularët. Ju keni kerkuar listepagesën, gjë që do të thotë se është plotësuar nga OE faza e deklarimit dhe pagesës së formulareve. Është e tepert dhe pa vlerë që pasi të paraqesim listepagesat, të paraqesim edhe formularët që kemi plotësuar përpara se të dilnin listepagesat e konfirmuara.

Gjykojmë që për të arritur qëllimin, AK I mjaftojnë listepagesat, dhe nuk është aspak e nevojshme që OE të paraqesin edhe formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Kjo kerkese vetëm sa I shton kohë punë OE për të përgatitur dokumentacionin.

Lutemi të hiqet kërkesa “shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”.

PIKA 5

Ne DST është përcaktuar:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

Certifikatën e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2013 (e vlefshme), të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose ekuivalente.

ARGUMENT 5

Standarti ISO/IEC 27001:2013 nuk është me I vlefshëm, ai është hequr nga përdorimi dhe është zëvendësuar me një standart me të përditësuar ISO/IEC 27001:2022.

Ju lutem referojuni faqes zyrtare të organizatës ndërkombëtare ISO (International Organization for Standardization):

<https://www.iso.org/contents/data/standard/05/45/54534.html>

ku sqarohet se ISO/IEC 27001:2013 është hequr nga përdorimi dhe është zëvendësuar me ISO/IEC 27001:2022

Ju lutem korrigjoni kriterin dhe kerkoni ISO/IEC 27001:2022.

PIKA 6

Në Termat e Referencës kërkohet:

TERMAT E REFERENCES

Terma reference/ specifikime teknike

Programi duhet të përmbushë specifikimet teknike minimale të mëposhtme:

1. Sistemi duhet të mundësojë kontrollin e aksesit bazuar në role, duke lejuar që çdo përdorues të aksesojë vetëm modulet dhe funksionalitetet për të cilat është autorizuar.
2. Sistemi duhet të mundësojë autentifikim të sigurt të përdoruesve me emër përdoruesi ose email dhe fjalëkalim.
3. Sistemi duhet t'i mundësojë administratorit shfaqjen, kërkimin dhe filtrimin e listës së përdoruesve sipas roleve dhe njësive organizative.
4. Sistemi duhet t'i mundësojë administratorit krijimin, përditësimin, aktivizimin, çaktivizimin dhe administrimin e profileve
5. e të përdoruesve dhe autorizimeve përkatëse.
6. Sistemi duhet të mundësojë administrimin e subjekteve tatimpaguese, duke përfshirë të dhënat identifikuese, kontaktet, statusin, historikun e faturave dhe detyrimeve.
7. Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin dhe administrimin e adresave dytësore të subjekteve, si dhe lidhjen e tyre me detyrimet përkatëse.
8. Sistemi duhet të mundësojë administrimin e pronave të lidhura me subjektet ose familjarët, duke përfshirë tipin e pronës, adresën, zonën kadastrale dhe identifikuesin unik të pronës.
9. Sistemi duhet të mundësojë krijimin, ndryshimin dhe administrimin e taksave të lidhura me pronat, duke përcaktuar periudhën e vlefshmërisë së tyre.
10. Sistemi duhet të mundësojë administrimin e faturave, duke shfaqur të paktën numrin e faturës, statusin e pagesës, shumën totale, shumën e paguar, shumën e papaguar dhe kamatëvonesat.
11. Sistemi duhet të mundësojë gjenerimin automatik të faturave mbi bazën e taksave të regjistruara.
12. Sistemi duhet të mundësojë krijimin e mandateve të pagesës për pagesa të plota ose të pjesshme.
13. Sistemi duhet të mundësojë administrimin e debitorëve dhe të shfaqë të paktën statusin e detyrimit, vitin fiskal dhe shumën totale të detyrimit.
14. Sistemi duhet të mundësojë krijimin, përditësimin dhe administrimin e detyrimeve debitorë, si dhe regjistrimin e pagesave të tyre.
15. Sistemi duhet të regjistrojë historikun (Audit Log) të veprimeve të kryera nga përdoruesit, duke përfshirë hyrjet në sistem, krijimin, ndryshimin dhe fshirjen e të dhënave, si dhe ndryshimet e statuseve.
16. Sistemi duhet të mundësojë gjenerimin e raporteve dinamike mujore, periodike dhe vjetore për të ardhurat, detyrimet, debitorët dhe statusin e pagesave.
17. Raportet duhet të mund të filtrohen sipas subjektit, familjarit, njësisë administrative,

kategorisë së taksës, statusit të pagesës dhe intervalit kohor.

18. Sistemi duhet të mundësojë dërgimin automatik të njoftimeve elektronike (email) për faturat e gjeneruara dhe detyrimet e papaguara.

19. Sistemi duhet të mundësojë importimin masiv të të dhënave nga skedarë Excel ose CSV.

20. Në rast se Autoriteti Kontraktor disponon shërbimet përkatëse, sistemi duhet të jetë i aftë të integrohet me sistemet e pagesave elektronike, bankare ose postare për reflektimin automatik të pagesave.

21. Sistemi duhet të mundësojë eksportimin e raporteve dhe listave në format PDF dhe Excel.

22. Sistemi duhet të krijojë automatikisht kopje rezervë (backup) të bazës së të dhënave dhe të mundësojë rikthimin e tyre.

23. Sistemi duhet të jetë i aksesueshëm përmes shfletuesve modernë (Chrome, Edge, Firefox dhe Safari) dhe të jetë i përshtatshëm për përdorim në kompjuter, tablet dhe telefon celular.

24. Programi duhet të përfshijë një portal elektronik për subjektet dhe familjarët, nëpërmjet të cilit secili përdorues, pas autentifikimit, të mund të konsultojë detyrimet, faturat, debitorët, pronat, historikun e pagesave dhe njoftimet që lidhen me llogarinë e tij.

25. Sistemi duhet të mundësojë kërkimin dhe filtrimin e të dhënave sipas emrit, NIPT-it, numrit personal, adresës, pronës, faturës dhe intervalit kohor.

26. Sistemi duhet të mundësojë ndryshimin e fjalëkalimit nga përdoruesi dhe rivendosjen e tij nga administratori i sistemit.

27. Portali elektronik duhet të jetë i aksesueshëm dhe i përshtatur për përdorim në kompjuter, tablet dhe telefon celular.

ARGUMENT 6.1

Termet e Referencës përcaktojnë funksionalitete të përgjithshme të programit, por nuk përcaktojnë qartë natyrën e shërbimit që prokurohet: zhvillim software nga e para, përshtatje e një sistemi ekzistues, licencim, abonim/SaaS apo furnizim me një produkt software të gatshëm. Këto alternativa kanë mënyrë realizimi dhe kosto thelbësisht të ndryshme.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë qartë nëse objekti është zhvillim, përshtatje, licencim apo ofrim i një sistemi ekzistues dhe të përcaktojë modelin konkret të implementimit dhe dorëzimit.

ARGUMENT 6.2

Nuk përcaktohet numri i përdoruesve, administratorëve, njësisve organizative, subjekteve tatimpaguese, familjarëve, pronave, faturave dhe regjistrimeve që sistemi duhet të përballojë. Pa këto të dhëna nuk mund të dimensionohen infrastruktura, baza e të dhënave dhe kostoja e sistemit.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë numrin aktual dhe volumin maksimal të pritshëm të përdoruesve, subjekteve, pronave, faturave dhe të dhënave që sistemi duhet të administrojë.

ARGUMENT 6.3

Nuk përcaktohet numri i përdoruesve njëkohësisht aktivë, koha maksimale e përgjigjes së sistemit dhe parametrat minimalë të performancës. Një sistem për dhjetëra përdorues dhe një sistem për mijëra përdorues kërkojnë arkitekturë dhe kosto të ndryshme.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë numrin maksimal të përdoruesve concurrent dhe kërkesat minimale të performancës/response time të sistemit.

ARGUMENT 6.4

Pikat 8?14 kërkojnë administrimin e pronave, taksave, faturave, kamatëvonesave, mandateve dhe debitorëve, por nuk përcaktojnë rregullat e biznesit dhe formulat e llogaritjes mbi të cilat sistemi duhet të funksionojë.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë rregullat e llogaritjes së taksave, kamatëvonesave, faturave,

pagesave të pjesshme dhe detyrimeve debitore, si dhe të gjitha rastet që sistemi duhet të trajtojë.

ARGUMENT 6.5

Pika 8 kërkon administrimin e pronave me zonë kadastrale dhe identifikues unik, por nuk përcaktohet burimi i të dhënave të pronës, nëse ato hidhen manualisht, importohen apo merren përmes integritimit me një sistem tjetër.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë burimin e të dhënave të pronës dhe mënyrën konkrete të regjistrimit, importimit apo integritimit të tyre në sistem.

ARGUMENT 6.6

Në pikën 20 kërkohet integrimi me sisteme pagesash elektronike, bankare ose postare “në rast se Autoriteti Kontraktor disponon shërbimet përkatëse”, por nuk identifikohen sistemet, API-të, protokollet, dokumentacioni teknik apo numri i integritimeve që mund të kërkohen.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë saktë sistemet me të cilat kërkohet integrimi, numrin e integritimeve dhe dokumentacionin/API-të që do të vihen në dispozicion, në të kundërt, këto integritime të mos përfshihen në çmimin e ofertës.

ARGUMENT 6.7

Kërkesa për import masiv nga Excel ose CSV nuk përcakton strukturën, numrin e skedarëve, numrin e rekordeve, formatin e kolonave dhe rregullat e validimit të të dhënave.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë shembujt e importit, strukturën e të dhënave dhe volumin maksimal të rekordeve që duhet të importohen.

ARGUMENT 6.8

Nuk përcaktohet nëse ekzistojnë të dhëna në një sistem aktual dhe nëse OE duhet të kryejë migrimin e databazës ekzistuese. Migrimi, pastrimi, transformimi dhe validimi i të dhënave përbëjnë një volum të konsiderueshëm pune që nuk mund të lihet i papërcaktuar.

Kërkesa: Lutemi AK-së të sqarojë nëse kërkohet migrim i të dhënave ekzistuese dhe, nëse po, të përcaktojë burimin, formatin, volumin dhe përgjegjësitë për pastrimin dhe validimin e tyre.

ARGUMENT 6.9

Pika 6 kërkon dërgim automatik e-mail, por nuk përcaktohet nëse AK disponon SMTP/e-mail service, numri i pritshëm i njoftimeve dhe kush mbulon infrastrukturën apo kostot e dërgimit.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë infrastrukturën e dërgimit të e-mail-eve, volumin e pritshëm të njoftimeve dhe përgjegjësinë për kostot përkatëse.

ARGUMENT 6.10

Pika 22 kërkon backup automatik dhe rikthim, por nuk përcakton frekuencën e backup-it, periudhën e ruajtjes, numrin e kopjeve, vendndodhjen e ruajtjes, RPO dhe RTO. Këto janë parametra thelbësorë për dimensionimin dhe çmimin e zgjidhjes.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë frekuencën dhe retencionin e backup-eve, vendndodhjen e tyre dhe kërkesat RPO/RTO për rikthimin e sistemit.

ARGUMENT 6.11

Kërkesat për autentifikim “të sigurt” dhe kontroll aksesi janë të përgjithshme, pa u përcaktuar politika e fjalëkalimeve, skadimi i sesionit, tentativat e dështuara, MFA/2FA apo kërkesat konkrete të sigurisë.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë standardet minimale dhe kërkesat e matshme të sigurisë për autentifikimin, sesionet, fjalëkalimet dhe mbrojtjen e llogarive.

ARGUMENT 6.12

Pika 15 kërkon Audit Log, por nuk përcakton kohën e ruajtjes, të dhënat që duhet të regjistrohen për çdo veprim, mundësinë e eksportimit dhe mbrojtjen e log-eve nga ndryshimi ose fshirja. Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë përmbajtjen minimale, periudhën e ruajtjes, mënyrën e aksesimit dhe kërkesat e integritetit të Audit Log-ut.

ARGUMENT 6.13

Pikat 16?17 kërkojnë “raporte dinamike”, por nuk përcaktojnë numrin e raporteve, strukturën, fushat, formulat dhe modelet e kërkuara. Termi “dinamike” mund të nënkuptojë një numër praktikisht të pakufizuar raportesh.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë listën e saktë të raporteve standarde që duhet të zhvillohen dhe funksionalitetet konkrete të raportimit dinamik.

ARGUMENT 6.14

Portali për subjektet dhe familjarët përfshin akses në detyrime, fatura, prona, historikun e pagesave dhe të dhëna të lidhura me llogarinë, por nuk përcaktohet mënyra e regjistrimit/verifikimit të identitetit të qytetarit dhe lidhja e tij me subjektin, familjarin apo pronën përkatëse.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë procesin e regjistrimit, verifikimit të identitetit dhe lidhjes së përdoruesit të portalit me të dhënat që ai autorizohet të konsultojë.

ARGUMENT 6.15

Nuk përcaktohet ku do të hostohet sistemi: në infrastrukturën e AK-së, cloud, data center të OE-së apo një zgjidhje tjetër. Gjithashtu mungojnë kërkesat për serverët, storage, bandwidth, certifikatat, domain-in dhe mjediset production/test.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë modelin e hostimit dhe të sqarojë se cila palë siguron infrastrukturën, serverët, storage, domain-in, certifikatat dhe kostot përkatëse.

ARGUMENT 6.16

Nuk përcaktohen kërkesat për trajnimin, manualët, suportin teknik, mirëmbajtjen, afatet e reagimit dhe ndërhyrjes, megjithëse këto janë pjesë thelbësore e implementimit dhe funksionimit të një sistemi të tillë.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë numrin e përdoruesve që do të trajnohen, orët/ditët e trajnimit, periudhën e mirëmbajtjes dhe SLA-të e suportit teknik.

ARGUMENT 6.17

Nuk përcaktohet procedura e testimit dhe pranimi të sistemit. Pa skenarë testimi dhe kriteret e pranimit, nuk ekziston një bazë objektive për të përcaktuar kur një funksionalitet konsiderohet i realizuar dhe kontrata e përmbyshur.

Kërkesa: Lutemi AK-së të përcaktojë kriteret e pranimit, testet funksionale dhe teknike dhe procedurën e validimit të sistemit para marrjes në dorëzim.

ARGUMENT 6.18

Termet e Referencës përshkruajnë një sistem me funksionalitete të shumta për administrimin e përdoruesve, tatimpaguesve, pronave, taksave, faturave, pagesave, debitorëve, raportimit dhe portalit elektronik, por mungojnë një sërë parametrash thelbësorë për dimensionimin dhe ofertimin e tij: modeli i sistemit, volumi i të dhënave, numri i përdoruesve, performanca, rregullat e biznesit, migrimi, integriteti, infrastruktura, siguria, backup-et, raportet, testimi, suporti dhe kriteret e pranimit.

Në këtë formë, OE-të mund të bëjnë interpretime dhe përlllogaritje krejt të ndryshme për të njëjtin objekt, duke cenuar përcaktimin e një volumi të njëjtë dhe të krahasueshëm të shërbimit.

Kërkesa: Lutemi AK-së të rishikojë dhe plotësojë Termet e Referencës, duke përcaktuar në mënyrë të qartë, të plotë dhe të matshme objektin, arkitekturën funksionale, volumin e sistemit, rregullat e

biznesit, integritet, migrimin, infrastrukturën, sigurinë, performancën, mirëmbajtjen dhe kriteret e pranimit, në mënyrë që të gjithë OE-të të ofertojnë mbi të njëjtën bazë teknike dhe ekonomike.

NE PERMBLEDHJE, KERKOJME PEZULLIMIN E PROCEDURES DHE HEQJEN /
NDRYSHIMIN E KRITEREVE DHE SPECIFIKIMEVE TE ANKIMUARA.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme ☐

Po ☐

Jo ☒

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

NUK KA

7. Lista e informacionit konfidencial: ☐

NUK KA

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. ☐

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

enkelejda.buxheli@optima.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Elton Rama